

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË TREGTARE**  
**ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"ENVIRONMENT ALBANIA"**

Në Tiranë, sot më datë **15.08.2017**, (dymijë e shtatëmbëdhjetë), ortaku i Vetëm Francesco Mario Ottati, i biri i Carmine, lindur në Itali më 20.02.1961, banues në Via delle More, 43, Potenza, Itali,

Mbështetur në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe në ligjin nr. 9723 datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", krijon shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "Environment Albania", duke hartuar këtë statut me kushtet e mëposhtme:

**NENI 1**  
**Emërtimi i shoqërisë**

- 1.1 Emërtimi i shoqërisë është "Environment Albania" shpk , e cila do të ketë vulën dhe logon e saj. Në të gjitha dokumentet, faturat, reklamat dhe botimet e publikuara nga shoqëria, emërtimi i saj do të paraprihet ose pasohet nga:
  - a) fjalët "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose inicialet sh.p.k.
  - b) numri i regjistrimit;
  - c) selia.

**NENI 2**  
**Forma ligjore e shoqërisë**

- 2.1 Shoqëria tregtare "Environment Albania" shpk është person juridik shqiptar, e formës së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, bazuar në legjislacionin shqiptar dhe që vepron sipas dispozitave të këtij Statuti.

### **NENI 3 Selia e shoqërisë**

- 3.1 Selia Qëndrore e shoqërisë "Environment Albania" shpk është në adresën: Rr. "Asim Vokshi", Nd.14, Hyrja 6, Ap.27, Tiranë, Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria rezervon të drejtën e trasferimit të selisë së saj në një adresë tjeter.

### **NENI 4 Shtrirja e aktivitetit të shoqërisë**

- 4.1 Shoqëria e shtrin aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridikcionin territorial të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.
- 4.2 Me vendim të Ortakut të Vetëm mund të krijohen ose anullohen (në rast se janë celur) filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë edhe jashtë saj. Njësitë strukturore të shoqërisë jashtë shtetit, si degë apo përfaqësi, krijohen në përputhje me legjislacionin e shtetit përkatës.

### **NENI 5 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë tregtare "**Environment Albania**" shpk është:

- a) Projektimi, shitja dhe mirëmbajtja e pajisjeve shkencore për analizat kimike dhe fizike të vazhdueshme në proceset industriale dhe në rrjetet e monitorimit dhe matjeve mjedisore për ajrin, ujin, tokën;
- b) Hapja e laboratorëve të analizave kimike, mikrobiologjike, farmakologjike, merceologjike për të provuar dhe kontrolluar cilësinë, analiza mjedisore dhe me pajisje për verifikimin dhe parandalimin e ndotjes së ajrit, të ujrave dhe të terreneve, dhe për ndotjen nga zhurmat dhe fushat elektromagnetike, e nga cdo lloj agjenti kimik e fizik tjeter, etj.;
- c) Shërbime për entet publike dhe private që lidhen me problematikat shëndetësore, mjedisore dhe në fushën e sigurisë në vendin e punës;
- d) Krijimi, organizimi dhe administrimi i kurseve të formimit profesional për përditësimin dhe kualifikimin profesional;
- e) Bonifikimi i territorit ose ndërtimeve nga ndotja me elemente kimike e fizike të dëmshme, përfshirë këtu edhe azbestin;



- f) Pjesëmarrja në tendera publikë e privatë.
- 5.2 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri ose ndërmarrje të tjera që kanë objekte veprimtarie të ngjashme, të afërta ose të lidhura me objektin e saj.
- 5.3 Shoqëria gjithashtu mund të ndërmarrë të gjitha veprimet që janë të lidhura në mënyrë funksionale me marrjen e kredive pranë bankave dhe enteve kreditore në përgjithësi si dhe të kryejë të gjitha veprimet tregtare, industriale që do të konsiderohen të dobishme dhe të përshtatshme për përbushjen e objektit të veprimtarise së shoqërisë.

## **NENI 6**

### **Kohëzgjatja e shoqërisë**

- 6.1 Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat.

## **NENI 7**

### **Kapitali themeltar i shoqërisë**

- 7.1 Kapitali Themeltar i shoqërisë "Environment Albania" shpk është 10.000 lekë (dhjetëmijë), që përfaqëson kontributet në para të Ortakut të vetëm, të depozituara në një nga Bankat e nivelit të dytë.
- 7.2 Ky kapital themeltar ndahet në 1 pjesë me vlerë nominale 1pjesë/10.000 lekë, i depozituar sipas ligjit.
- 7.3 Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

## **NENI 8**

### **Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar**

- 8.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil dhe atij Tregtar.
- 8.2 Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

**NENI 9**  
**Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar**

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë mund të rritet ose zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetëm, duke bërë dhe ndryshimin në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 10**  
**Veprimet financiare**

- 10.1 Shoqëria hap llogari bankare në lekë dhe në cdo lloj valute të huaj, në Banka vendase ose të huaja, për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin finanziar të aktivitetit të saj. Administratori i emëruar nga Ortaku i Vetëm depoziton firmën e tij origjinalë në Bankat ku janë celur llogaritë.

**NENI 11**  
**Mbështetja ligjore e veprimtarisë së shoqërisë**

- 11.1 Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me legjislatacionin shqiptar në fuqi si atë tregtar, civil, doganor, tatimor, fiskal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore specifike për ushtrimin e saj, sipas objektit të veprimtarisë së saj, mbi bazën e Statutit të saj dhe normat e së drejtës tregtare ndërkombëtare.

**NENI 12**  
**Organet drejtuese të shoqërisë**

- 12.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:
- Ortaku i Vetëm;
  - Administratori.

**NENI 13**  
**Administratori**

- 13.1 Administratori kryen të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë dhe ushtron të gjitha kompetencat në emër të shoqërisë

në marrëdhënie me të tretët, me përjashtim të atyre që ligji dhe ky Statut ia jep shprehimisht Ortakut të Vetëm.

- 13.2 Administratorit nuk i lejohet të marrë hua nga shoqëria, të japë pëlqimin në emër të saj për paradhënie si dhe të bëhet dorëzanës apo garantues në emër të saj në angazhimet ndaj të tretëve.
- 13.3 Administratori është individualisht përgjegjës ndaj shoqërisë apo të tretëve, për veprime të kryera në shkelje të ligjeve ose që bien në kundërshtim me këtë Statut dhe për dëmin e shkaktuar me faj.
- 13.4 Administrator i shoqërisë është **Z. Francesco Mario Ottati**, i cili zgjihet për një afat pesë vjetë, me të drejtë rinovimi.

#### **NENI 14** **Llogaritë vjetore**

- 14.1 Veprimet ekonomiko financiare të shoqërisë mbyllen më datë 31 Dhjetor të cdo viti.
- 14.2 Bilanci kontabël vjetor miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim nga ortakët, i cili jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecantë etj.
- 14.3 Të ardhurat neto (dividenti) që mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbesin dhe i kalojne në pronësi ortakut të vetëm të shoqërisë.

#### **NENI 15** **Prishja e shoqërisë**

- 15.1 Prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë dhe për cfarëdolloj shkaku që parashikohet në ligj ose me vendim të Ortakut të Vetëm. Në këtë rast, Ortaku i Vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe duke shënuar në cdo dokument të nxjerrë prej saj emrin e likuidatorit dhe emrëtesën shtesë "Shoqëri në likujdim e sipër".

Ky statut u redaktua në 4 kopje me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë tregtare "Environment Albania" shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur firmën e tij orgjinale.

Përgatitur dhe nënshkruar në Tiranë më 15.08.2017.

**ORTAKU I VETËM  
I SHOQËRISË "ENVIRONMENT ALBANIA" SHPK**

Francesco Mario Ottati

*Përfundon më prokurin  
pasqyrë nr. 1803 Rep. 807/2 koi  
nga Ar. Klaudiq Xhufi*

